



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:066377

Datë: 13.12.2023

Numri i dokumentit: 05058394

SCC-11-0177

Paditës - Propozues

R N dhe B D nga f.sh P K.Prizren ,
Të cilët i përfaqëson Y K avokat nga Prizreni.

Kundër:

E paditur – Pala kundërshtare:

Agjencia Kosovare e Privatizimit , rr. “Dritan Hoxha ” nr. 55, Lakrishte –Prishtinë,

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), Kolegji i përbërë nga gjyqtarja Hajrie Shala kryesuese, Asllan Krasniqi dhe Agron Hoxhaj gjyqtarë, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur me dt. 12 dhjetor 2023, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Kërkesa për Masë të Sigurimit, refuzohet si e pa bazuar .**
- 2. Nuk caktohen taksa gjyqësore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me dt.31 dhjetor 2007, paditësi B D ka paraqitur padi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës kundër të paditurës N.SH “Farmakos” dhe N.SH “Progres”, me objekt të kontestit dorëzimi i pasurisë së paluajtshme, për ngastrën kadastrale nr... në sipërfaqe prej 21.19h, ngastra kadastrale nr.... në sipërfaqe prej 22.39h dhe ngastra kadastrale nr. ..në sipërfaqe prej 35.99h, të gjitha gjenden në vendin e quajtur “B” ZK Prizren, ku është formuar

lënda SCC-07-0557. Lidhur me këtë lëndë DHPGJS ka vendosur me aktvendimin e saj të dt.04 shkurt 2010, duke e hedhur padinë si të pa pranueshme.

Me dt.05 korrik 2011, i autorizuari i paditësit ka paraqitur në gjykatë një kërkesë, në të cilën ka theksuar se në DHPGJS është iniciuar procedura me anë të lëndës SCC-07-0557, nga B D i cili tani ka ndërruar jetë, kurse djemtë e tij R N dhe B D dëshirojnë që të marrin përsipër procedurën. Ka shtuar se fillimisht është iniciuar procedura në Gjykatën Komunale në Prizren ku me anë të aktgjykimit P.nr/508/94 dt.13.02.1997 është aprovuar padia dhe është anuluar kontrata e shitjes e lidhur në mes të B D dhe N.SH “Progres”. Të njëjtës ia ka bashkangjitur këto prova: Aktvdekjen e B D, Propozim dt.30.06.2011, Autorizim, Akt i noterizuar për ndërrimin e mbiemrit të B D –B C .

Me anë të parashtrësës së dt.09 mars 2016, i autorizuari i paditësve ka bërë dorëzimin e aktvendimit për trashëgimi të Gjykatës Themelore në Prizren T.nr.254/11 dt.16.10.2014, me të cilin R, N dhe B D shpallen trashëgimtar të B D.

Me aktvendimin C-III.-12-0913 të dt.18 prill 2016, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës, ka vendosur që kjo lëndë të i bashkohet lëndës SCC-11-0177.

I autorizuari i palës paditëse me dt.29 shtator 2023 ka paraqitur Propozim për Caktimin e Masës së Sigurimit, ku ka pohuar se: Me aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren C.nr.508/94 dt.13.02.1997 është vërtetuar nuliteti i kontratës mbi shitblerjen Leg.nr.... dt... për parcelat kadastrale nr... dhe.. ZK Prizren, kurse me vendimin e Drejtorisë për Pronësi të Komunës së Prizrenit nr.03/3-463-12 i dt.15.06.1977 eksproprijohet parcela nr... ZK Prizren, e më vonë barten në pronësi të NSH “Farmakos”, e më vonë këto tri parcela nga Zyra për Kadastër Prizren janë bashkuar dhe evidentohen me numër unik .. ZK Prizren. Në kohët e fundit këto parcela po tentohet që të uzurpohen nga persona të tretë, për këtë për të iu shmangur dëmeve që mund të iu shkaktohen paditësve me ndërtimet eventuale apo nga ana e AKP-së, të cilat nuk mund të riparohen propozohet që të caktohet masa e sigurisë dhe të ndalohet tjetërsimi, ndërtimi apo çfarëdo ngarkese tjetër në parcelat kadastrale nr..., ..dhe.., tani me numër unik .. ZK Prizren.

Gjykata me dt.03 tetor 2023 i ka dërguar palës paditëse AKP, propozimin për masë të sigurisë, e cila me dt.09 tetor 2023 ka paraqitur përgjigjen, ku ka pohuar se i kundërshton të gjitha pretendimet e paditësve të paraqitura në padinë e tyre të konsideruara si të pa bazuara në ligj. Ka shtuar se paditësit i janë drejtuar AL me kërkesë dhe për këtë është vendosur me vendimin PRZ026-0159 dt.04.12.2012, ndaj të cilit paditësi nuk ka ushtruar ankesë. Paditësit nuk kanë paraqitur dëshmi përmes të cilave kanë kërkuar kalimin e pronës kontestuese që nga vitit 1977 deri në vitin 2007, kur kishte dorëzuar padi për njohjen e pronësisë kontestuese. Konsideron se nuk ekziston asnjë raport materialo – juridik mes paditësit dhe NSH-së, pasi që me vendimin e Drejtorisë për Marrëdhënie Pronësore – Juridike të K. Prizrenit prona kontestuese bartet nga PIK – Progres te Farmakos. Pra, shpronësimi ishte kompetencë e organeve shtetërore. Lidhur me Propozimin për Masë së Sigurisë ka pohuar se propozuesi nuk e ka bërë të besueshme pretendimin se masa është e bazuar duke prezantuar urgjencën e çështjes e cila kërkohet në këtë rast. Sipas njoftimit të Zyrës Rajonale të Prizrenit, ngastrat e pretenduara nuk janë paraparë për tu privatizuar. Ka propozuar që të hedhet poshtë si e pa pranueshme kërkesa për urdhër paraprak gjyqësor, ose të refuzohet si e pa bazuar në ligj.

Arsyetime Ligjor

Kërkesa për masë të sigurimit është e pabazuar.

Sipas nenit 61 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, Dhoma e Posaçme mund të nxjerr një masë të sigurimit me kusht që parashtruesi të ofrojë prova të besueshme se do të ketë dëme të menjëhershme dhe të pariparueshme për palën nëse nuk miratohet masa e sigurimit. Dëmi konsiderohet si i pariparueshëm vetëm nëse nuk mund të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar.

Paditësi i cili kërkon urdhër paraprak gjyqësor duhet të dorëzoj dëshmi të besueshme se:

1. ekziston e drejta dhe
2. kjo e drejtë mund të dëmtohet në mënyrë të pariparueshme nëse nuk miratohet masa e sigurimit.

Barra e provës është tek paditësja, kështu që përveç që e njëjta duhet të ofroj dëshmi të besueshme se e drejta e rrezikuar ekziston, duhet të ofrojë dëshmi dhe ta bëjë të besueshme faktin se do të shkaktohet dëm i menjëhershëm dhe i pariparueshëm, nëse nuk aprovohet kërkesa për masë të sigurimit.

Ekzistimi i së drejtës së pretenduar

Pa paragjykuar zgjidhjen përfundimtare të këtij kontesti, Kolegji vlerëson se paditësit në këtë fazë të procedurës, nuk kanë dorëzuar dëshmi të besueshme se ekziston e drejta e pretenduar në favorin e tyre. Pretendimet e paditësve nuk mund të merren si provë për caktimin e masës së sigurisë. Mbi bazën e këtyre provave të dorëzuara nuk mund të konstatohet ekzistimi i të drejtës së tyre të pretenduar.

Aq më pak kur, në bazë të provave të cilat paditësit i kanë deponuar vërehet se lidhur me pretendimet e tyre janë udhëhequr disa procedura dhe asnjëra nuk ka marr një epilog përfundimtar . Pastaj, Aktvendimet e dorëzuara në fotokopje, vendimet, listat poseduese dhe provat tjera tani për tani nuk flasin për ekzistimin e të drejtës së tyre mbi pronat kontestuese dhe paditësve nuk u jep të drejtë për të kërkuar caktimin e masës së sigurisë.

Gjykata vlerëson se nuk është plotësuar as kushti për *dëm të menjëhershëm* për caktimin e Masës së sigurimit, pasi që paditësit nuk kanë paraqitur ndonjë rrethanë, nga e cila pritet të pësojë ndonjë dëm të menjëhershëm dhe se nuk ka dorëzuar dëshmi të besueshme se kjo e drejtë mund të dëmtohet menjëherë, nëse nuk miratohet kërkesa për masë të sigurimit.

Sipas dispozitave ligjore *dëmi konsiderohet si i “pariparueshëm” vetëm nëse nuk mund të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar*. Pra sipas kësaj fjalisë edhe po t'i shkaktohej dëm paditësve i cilin pretendojnë se pa të drejtë u është marr prona, prapë ky dëm nuk do të ishte i pariparueshëm, pasi që atyre do tu kompensohej dëmi i shkakuar me anë të një kompensimi financiar. Në rastin konkret edhe kushti për dëm të pariparueshëm, si kusht për tu caktuar masa e sigurimit nuk është plotësuar.

Për më tepër gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, provave të parashtruara nga paditësi dhe pretendimeve të parashtruara në padi gjeti se, paditësit kërkesën e tyre e orientojnë në rrezikun e tjetërsimit për parcelat kadastrale .. dhe .. të dyja ZK Prizren për të cilat me aktgjykimin e Gjykatës Komonale në Prizren C.nr 508/94 të dt. 13.02.1997 është vërtetuar nuliteti i kontratës së shitblerjes Leg.nr... të dt.... Ndërsa, me aktvendimin e Drejtorisë së Komunës së Prizrenit nr.03/3-463-12 të dt.15.06. 1977 parcela kadastrale .. ZK Prizren eksproprijohet dhe bartet në pronësi të Fabrikës “Farmakos “, ashtu që tri parcelat nga zyra kadastrale në Prizren janë bashkuar dhe tani evidentohen në numrin unik .. ZK Prizren.

Padiësit më tutje kanë theksuar se, duke qenë se fabrika “Farmakos” është në shkatërim e sipër dhe ka tentime nga personat e tretë që ta uzurpojnë për ndërtime, e në këtë rast dëmi i shkaktuar me ndërtime apo tjetërsimi nga AKP-ja nuk do të mund të riparohen .

Pala duhet të ofrojë prova të besueshme se do të rezultojë me dëmtim të *menjëhershëm* dhe të *pariparueshëm financiarisht* nëse nuk miratohet kërkesa. Këto kritere janë përcaktuar në atë mënyrë që nëse ndonjëra nga arsyet e mësipërmet mungon, kërkesa do të refuzohet.

Pa paragjykim të vendosjes së plotë lidhur mbi padinë, gjykata gje se në këtë rast, paditësit nuk kanë ofruar dëshmi të besueshme, që do të arsyetonte lëshimin MS, pra nuk kanë parashtruar asnjë dëshmi mbi ekzistimin e rrezikut të dëmit që do të argumentonte që dëmi i menjëhershëm dhe i pariparueshëm do të shkactohej në qoftë se Masa e Sigurimit nuk do të lëshohej. Nuk mund të merren si prova tendencat e personave të tretë për uzurpim, me qëllim ndërtimi, ndërsa çështja e tjetërsimit nga AKP-ja është sqaruar në përgjigjen ndaj kërkesës për masë të sigurisë të cilët kanë theksuar se sipas njoftimit nga Zyra Rajonale në Prizren, ngastrat e përmenduar nuk janë paraparë për tu privatizuar.

Në këtë rast gjykata nuk ka gjetur se kërkesa për Masë të Sigurimit mund të ketë mbështetje në dispozitën e nenit 61 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme prandaj, kërkesa si e tillë u refuzua.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Shpenzimet Gjyqësore

Paditësi tani më ka paguar taksen gjyqësore për kërkesën për masë të sigurimit në shumë prej 100.00 € dhe nuk ngarkohet me taksa shtesë.

Këshillë Juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme Brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Hajrie Shala, Gjyqtare kryesuese

Asllan Krasniqi , Gjyqtar

Agron Hoxha, Gjyqtar